

Gjykata Supreme e Kosovës
AP – Kž. Nr. 368/2009
6 prill 2010

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Norbert Koster si Kryetar i kolegjit, gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Avdi Dinaj, Valdete Daka dhe Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Eriona Bitri Brading si procesmbajtëse.

Në lëndën penale kundër të pandehurit (D. [redacted] emri i babait [redacted] mbiemri i vajzërisë së nënës [redacted] i lindur më [redacted] në fshatin [redacted] vendbanimi i fundit në fshatin [redacted]

nuk ka qenë i dënuar më parë,

i mbajtur në paraburgim prej 29 majit 2008,


i akuzuar për veprën penale të vrasjes nga gjakmarja dhe në mënyrë brutale dhe tinëzare në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2 pikave 1 dhe 4 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPK), lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP RSFJ-së),

duke vendosur mbi ankesat e paraqitura nga Avokatët mbrojtës Fazli Balaj (e datës 26 gusht 2009) dhe Zenel Mekaj (e datës 25 gusht 2009) në emër të të pandehurit, dhe nga Avokati Haxhi Millaku (e datës 12 gusht 2009) në emër të palës së dëmtuar kundër aktgjykimit P.Nr. 178/2008, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë, më 11 qershor 2009,

në seancën e mbajtur më 06 prill 2010, pas këshillimit dhe votimit lëshon këtë

AKTVENDIM

PRANOHEN ankesat e paraqitura nga Avokatët mbrojtës Fazli Balaj dhe Zenel Mekaj. **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i datës 11 qershor 2009, dhe lënda **KTHEHET** për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.



Ankesa e paraqitur nga Avokati Haxhi Millaku në emër të palës së dëmtuar për momentin nuk është çështje e lëndës.

Paraburgimi kundër të të akuzuarit vazhdohet për **dy (2) muaj deri më 5 qershor 2010**, sipas neneve 281 dhe 424, paragrafit 6 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së). Vendimi mbi vazhdimin e mëtutjeshëm të paraburgimit bie në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë sipas nenit 429, paragrafit 5 të KPPK-së

Arsyetimi:

I. Historia e procedurës

Më 19 maj 2004, rreth orës 10:30, në
janë qëlluar për vdekje.

viktimat D. dhe T. A.

Hetimet penale kundër të akuzuarit kanë filluar më 28 korrik 2005. Me aktakuzën e datës 25 gusht 2005, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ka ngarkuar të pandehurin me dy akuza të Vrasjes në shkelje të nenit 30, paragrafit 2, pikave 1 dhe 4 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK-së), lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP RSFJ-së). Aktakuza është konfirmuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktvendimin e datës 17 tetor 2008.

Më 26 janar 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it në bazë të kërkesës së paraqitur nga Avokati mbrojtës Fazli Balaj ka lëshuar një vendim që kolegjit të përbëhet nga dy (2) gjyqtarë të EULEX-it dhe një (1) gjyqtar vendor.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mes të 21 prillit 2009 dhe 11 qershorit 2009. Kolegji, më 11 qershor 2009 ka shpallur të pandehurin fajtor për dy (2) vepra penale të Vrasjes "të kryer nga gjakmarrja në mënyrë brutale dhe tinëzare" në kundërshtim të nenit 30, paragrafin 2, pikat 2 dhe 4 të LPK-së, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP RSFJ-së), dhe i ka shqiptuar atij dënime të ndara prej njëzet (20) vjetësh burgim për secilën vepër të Vrasjes, duke rezultuar në një dënim unik prej tridhjetetë (33) vjet burgim. Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar palëve në mes të 11 dhe 16 gushtit 2009.

Më 24 gusht 2009, avokati Isa Osdautaj, në emër të të akuzuarit ka paraqitur një ankesë kundër aktgjykimit. Kjo ankesë është hedhur poshtë si e palejueshme nga gjykata e shkallës së parë me arsyetimin se Avokati ka dështuar t'i dorëzoj gjykatës autorizimin. Kundër këtij Aktvendimi të Gjykatës së Qarkut nuk është paraqitur ankesë. Gjithashtu më 24 gusht, Avokati Haxhi Millaku si përfaqësues i palës së dëmtuar ka paraqitur një ankesë kundër aktgjykimit. Më 26 gusht 2009, Avokatët mbrojtës Fazli Balaj dhe Zenel Mekaj në emër të të akuzuarve kanë paraqitur ankesa kundër aktgjykimit.



II. Çështjet e ngritura në ankesa:

Avokati mbrojtës Fazli Balaj propozon që të lëshohet një vendim për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Ai pohon se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe kodit penal.

Në veçanti Avokati mbrojtës Fazli Balaj pretendon:

1. Shkeljet e dispozitave të procedurës penale:

- a. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut paraqet shkelje esenciale të nenit 403, paragrafit 1 dhe nenit 391, paragrafit 2, pikave 1, 2 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), sepse dispozitivi është i paqartë. Aktgjykimit të ankimuar i mungon përshkrimi faktik pasi që faktet vendimtare nuk janë përmendur as në dispozitiv e as në arsyetim. Prandaj, aktgjykimi duhet të anulohet.
- b. Edhe pse i akuzuari është shpallur fajtor vetëm për një (1) akuzë të vrasjes – vrasjen e D. A. – ai është dënuar për dy (2) akuza të vrasjes.
- c. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar që t'i vërtetojë faktet në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Skica e bashkangjitur në aktgjykim nuk e reflekton realitetin e vendit të krimit. Kërkesat e mbrojtjes për inspektimin e vendit të krimit në mënyrë që të mundësohet një vlerësim i drejtë i deklaratave të dëshmitarëve janë refuzuar nga gjykata. Në veçanti deklaratat e M. B. është dashur të vlerësohen në aspektin se nga vend shikimi i tij, ai fizikisht nuk ka qenë në gjendje të shoh atë që ka raportuar se kishte parë.
- d. Dëshmitarit kryesor – L. A. – nuk mund t'i besohet. E njëjta vlen edhe për dëshmitarët G. N. A. N. dhe V. N.

2. Shkeljet e kodit penal



- a. Sipas nenit 30, paragrafit 3 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë është dashur të shqiptojë një (1) dënim për vrasjen e dy (2) personave në vend të një dënimi unik për dy akuza të vrasjes.
- b. Në termat ligjor vrasja nga gjakmarrja dhe vrasja e kryer në mënyrë brutale dhe tinëzare e përjashtojnë njëra tjetrën.

Avokati mbrojtës Zenel Mekaj propozon lëshimin e një vendimi për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe kthimin e lëndës për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Ai pohon se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe kodit penal.

Në veçanti ai pretendon:

1. Shkeljet e dispozitave të procedurës penale:

- a. Aktgjykimi shkel nenin 403, paragrafin 1, pikën 12 të KPPK-së, sepse sipas asaj që është cekur si fakt në aktgjykim, i akuzuari ka shtënë nga pjesa e përparme e veturës kurse D. A. ishte qëlluar nga tetë (8) plumba të cilët ishin shtënë nga pjesa e prapme dhe T. A. është qëlluar nga gjashtë (6) plumba të cilët janë shtënë nga ana e djathtë.
- b. Gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë korrekte dhe të plotë. Mënyra se si janë mbledhë provat materiale në vendin e krimit nuk janë të mjaftueshme për një vendim të balancuar dhe përfundimtar. Sidoqoftë, është e qartë se i akuzuari nuk ka mundur të shtijë në veturë nga pjesa e përparme, siç është deklaruar nga dëshmitari L. A. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar të zhvillojë inspektimin e vendin e krimit që do të zbulonte se disa nga dëshmitarët kanë bërë vrojtime të cilat ata nuk kanë qenë në gjendje që t'i bëjnë.

2. Shkeljet e kodit penal:

- a. Vrasja nga hakmarrja nuk mund të konsiderohet si tinëzare pasi që viktima është në dijeni të sulmit të mundshëm. Përveç kësaj, është kontradiktore të konstatohet se i akuzuari ka shtënë në veturë nga pjesa e përparme nga një pozitë e dukshme dhe që në të njëjtën kohë ka vepruar në mënyrë tinëzare.




- b. Gjykata e shkallës së parë ka bërë një gabim elementar duke shqiptuar ndaj të akuzuarit “burgim” në vend të “burgimit afatgjatë”. Për më tepër, llogaritja e dënimit merr parasysh si faktor rëndues “rolin e rëndësishëm të D. ...”, i cili supozohet se ka qenë para veturës pa e specifikuar veprimin e tij.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, avokati Haxhi Millaku, propozon ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shqiptimin e një dënimi më të ashpër ndaj të akuzuarit. Ai pretendon se burgimi me tridhjetetë (33) vjet nuk është në proporcion me nivelin e përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Duhet marrë parasysh se krimet e kryera nga gjakmarrja duhet të trajtohet si relikte të së kaluarës të cilat nuk vend në shoqërinë moderne.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) në mendimin e datës 16 nëntor 2009, propozon se ankesat e paraqitura nga Avokatët mbrojtës janë të bazuara lidhur me arsyet e ankesës për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk ka listuar shënimet personale të të akuzuarit. Përveç kësaj, dispozitivi nuk është i qartë dhe i kuptueshëm sepse nuk jep arsye mbi faktet vendimtare. Prandaj, aktgjykimi i ankimuar nuk është në përputhje me dispozitat e neneve 391 dhe 396, paragrafin 1 të KPPK-së, dhe si pasojë duhet të anulohet madje *ex officio* sipas nenit 415, paragrafit 1, pikës 1 të KPPK-së.

Për më tepër, ZPSHK-ja është e mendimit se aktgjykimi i ankimuar shkel dispozitat e ligjit penal sepse të akuzuarit i janë shqiptuar dy (2) dënime për dy (2) vrasje edhe pse ai është shpallë fajtor vetëm për vrasjen lidhur me një (1) viktimë.

Për këto arsye ZPSHK-ja është përmbajtur nga shqyrtimi dhe vlerësimi i arsyeve të tjera të ankesave të ngritura nga palët dhe propozon që ankesat e avokatëve mbrojtës të aprovohen dhe të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.



III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

1. Ankesat e avokatëve mbrojtës Fazli Balaj dhe Zenel Mekaj janë të paraqitura me kohë dhe të pranueshme.

Ato janë gjithashtu të bazuara. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë tregon shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm.

Elementet e aktgjykimit janë të përcaktuara qartë me nenin 396, paragrafin 1 të KPPK-së, sipas të cilit një aktgjykim duhet të ketë hyrjen, dispozitivin dhe bazën. Përmbajtja e obligueshme e dispozitivit si *tenor sententiae* është specifikuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 396 të KPPK-së. Paragrafi 4 i nenit 396 të KPPK-së përcakton që dispozitivi në rastin e dënimit duhet të përmbajë të dhënat e domosdoshme të specifikuara në nenin 391 të KPPK-së.

Neni 391 i KPPK-së në pjesët përkatëse shkruan si në vijim:

(1) Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon


1) *Për cilën veprë shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;*

2) *Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit*

3)

Prandaj, dispozitivi si pjesë shumë esenciale e aktgjykimit duhet të përmbajë jo vetëm kualifikimin ligjor të veprës por gjithashtu një përshkrim të detajuar dhe preciz të të gjitha fakteve dhe rrethanave të cilat janë bazë për aplikimin e dispozitave ligjore. Çfarëdo lloji i dykuptimësisë apo kontradiktës e bënë dispozitivin të pakuptueshëm.

Në lëndën në fjalë, dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk i reflekton këto kushte ligjore. I akuzuari është shpallur fajtor



“ për veprën penale Vrasje, të kryer nga gjakmarrja dhe në manarë brutale dhe tinëzare të T. A. , sipas nenit 30, par. 2, pikat 1 dhe 4 të Ligjit penal të Kosovës të vitin 1977, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Jugosllavisë, të kryer te më 19 mars 2004

Dhe

për veprën penale Vrasje, të kryer nga gjakmarrja dhe në manarë brutale dhe tinëzare të D. A. , sipas nenit 30 par. 2, pikat 1 dhe 4 të Ligjit penal të Kosovës të vitin 1977, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Jugosllavisë, të kryer te më 19 mars 2004;”

në dispozitiv përmendet vetëm një numër i vogël i fakteve, respektivisht emri i viktimave si dhe data dhe vendi i krimit. Kjo nuk është e mjaftueshme, siç edhe është theksuar në mënyrë të saktë nga ZPSHK-ja në mendimin e saj. Përshkrimi i nevojshëm faktik i veprimeve konkrete të kryera nga i akuzuari, p.sh. mënyra me të cilën i ka privuar viktimat nga jeta, mungon në tërësi. E njëjta vlen edhe për paramendimin e tij i cili është parakusht i domosdoshëm për vrasjen, sidoqoftë nuk është cekur fare në diapozitiv. Vetëm këto lëshime e bëjnë dispozitivin të pakuptueshëm¹.


Për më tepër, dispozitivi është i paqartë kur i referohet rrethanave rënduese “në mënyrë brutale dhe tinëzare”. Dispozitivi nuk duhet të ofroj opsione, p.sh. ose brutale ose tinëzare, duke vepruar në këtë mënyrë pa e specifikuar cila prej dy opsioneve në të vërtetë është aplikuar nga gjykata. Në të kundërtën kriteri dhe elementet e krimit që janë vërtetuar nga gjykata duhet të identifikohen qartë në diapozitiv dhe mos të ketë dykuptimësi. Përveç kësaj, gjithashtu faktet lidhur me këto elemente specifike të krimit – p.sh. vrasja në mënyrë brutale ose tinëzare – duhet të përshkruhen në diapozitiv në mënyrë që të arsyetohet përfundimi lidhur me cilësimin ligjor.

Veç kësaj, referimi në dispozitiv të neni 22 i Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP të RSFJ-së)² tregon se i akuzuari është shpallur fajtor duke vepruar si bashkë-kryes në bashkëpunim me kryesit e tjerë të krimit. Megjithatë, dispozitivi nuk e specifikon këtë dhe dështon të përshkruaj ndonjë fakt lidhur me këtë bashkë-kryerje.

Si rezultat dispozitivi e lë plotësisht të hapur në cilën mënyrë viktimat janë vrarë dhe saktësisht në cilën mënyrë i akuzuari kontribuoi në atë vrasje.

¹ Për lëshimet lidhur me paramendimin shih gjithashtu komentarin e Momcillo Grubac dhe Tihomir Vassiljevic, mbi (i aplikueshëm deri në prill 2004) Ligjin e Procedurës Penale, botimi i 2-të, 1982, paragrafët prej 52 deri në 364 pika 11.

² Termi “Ligji Penal Jugosllav”, siç është përdorur në dispozitiv nuk është titulli zyrtar i këtij ligji.



Në pajtim me nenin 403 paragrafi 1, pika 12 të KPPK-së është shkelje e dukshme absolute e dispozitave të procedurës penale nëse diapozitivi i aktgjykimit ishte i pakuptueshëm. Në pajtim me nenin 424 paragrafi 1 të KPPK-së kjo shkelje nuk lejon asnjë opsion tjetër për gjykatën e apelit përveç anulimit të aktgjykimit dhe të kthimit të lëndës për rigjykim. Përfundimet e mundshme – shih nenin 424, paragrafi 2 dhe nenin 426, paragrafi 1 të KPPK-së – nuk aplikohen pasi që ato i referohen shkeljeve të dispozitave të procedurës penale të drejtuara prej pikave 5, 8, 10 dhe 11 të nenit 403, paragrafi 1 të KPPK-së.

Mund të diskutohet se e vetmja zgjidhje e parashikuar prej ligjit – prishja e aktgjykimit dhe rigjykimi vetëm për arsye formale – është shumë e ashpër dhe i nevojitet interpretim korrigjues të ligjit me qëllim të shmangies së rigjyimeve. Lënda në fjalë, megjithatë, nuk është e përshtatshme për fillimin e diskutimit qoftë në cilat rrethana dhe se si interpretimi korrigjues i ligjit me qëllim të ndryshimit të aktgjykimit të shkallës së parë do të jetë ligjërish i arsyeshëm. Për minimumin e kërkesave për fillimin e diskutimit të këtillë ligjor do të duhej paraqitja e saktë dhe precize e fakteve mbi baza të aktgjykimit të shkallës së parë. Vetëm nën këtë parakusht gjykatës së apelit do t'i ishte mundësuar të ndryshoj dispozitivin duke e plotësuar atë me faktet e paraqitura në bazat e aktgjykimit. Megjithatë, edhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë i datës 11 qershor 2009, nuk ofron paraqitjen e kërkuar të fakteve mbi baza. Në të kundërtën mungesa e përshkrimit faktik në dispozitiv gjen korrespondencën (ngjashmërinë) gjithashtu në arsyetimin e aktgjykimit i cili nuk është në pajtim edhe me dispozitat e ligjit. Neni 396, paragrafi 7 i KPPK-së parashikon që gjykata në paraqitjen e bazës duhet të theksoj

“në mënyrë të qartë dhe të shterur se cilat fakte i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara”.

Paraqitja e tillë, e cila duhet të jetë përshkrimi preciz, i saktë, faktik dhe gjithëpërfshirës i ngjarjeve nuk mund të gjendet në aktgjykimin e shkallës së parë. Vetëm kah fundi i aktgjykimit, nën titullin “4.7. vlerësimi i përbashkët i elementeve kundërt të pandehurit”³ është paraqitur një numër i vogël i fakteve. Serioziteti i kësaj liste, megjithatë për shumë arsye është i diskutueshëm.

Nuk është aq e qartë nëse faktet e paraqitura janë ato që janë vërtetuar prej gjykatës së shkallës së parë. Në njërin anë lista është paraqitur me vërejtjen se “këtë fakte janë konsideruar të jenë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm”. Në anën tjetër vlerësimi i fakteve të paraqitura prej mbrojtjes pason këtë listë të fakteve edhe pse faktet nuk mund të përcaktohen “përtej dyshimit të arsyeshëm” para vlerësimit të fakteve së bashku duke përfshirë faktet e përfshira nga mbrojtja. Veç kësaj lista është gjithçka por shteruese. Rikonstruktimi i ngjarjes së gjuajtjes, derisa është i mundur mbi baza të fakteve në dispozicion, nuk mund të gjendet. Sa i përket kontributit të të akuzuarit thjesht deklaron se “D: [] ishte në mesin e sulmuesve në pusi”, që nuk është e mjaftueshme të

³ Referencë më specifike nuk është e mundur pasi që aktgjykimit i mungon numërtimi i faqeve.



shpjegohet vepra dhe fajësia e tij. E as që e lejon përfundimin se i akuzuari ka pasur “rol të dukshëm (rëndësishëm) me rastin e të shtënave”, megjithatë më vonë e përdori si rrethanë rënduese kundër tij⁴. Elementi rëndues “në mënyrë të fshehtë (tinëzare)” është në listën e fakteve të hequra prej idesë së thjeshtë që “vrasësit i kanë zënë në pusi viktimat duke i kapur atë tërësisht në befasi”, edhe pse konkluzioni që viktimat janë zënë në befasi nuk mbështetet me asnjë fakt.

Përshkrimi i tillë i pamjaftueshëm i fakteve në bazë të aktgjykimit nuk do të lejonte Gjykatën Supreme që teknikisht të korrigjoj dispozitivin duke e plotësuar atë me faktet e përshkruara në arsyetim, edhe pse ndryshim i tillë i aktgjykimit të shkallës së parë ligjërisht ishte i mundur. Kështu që pyetja nëse dhe nën cilat rrethana të jashtëzakonshme ndryshimi i dispozitivit nga gjykata e apelit do të ishte i mundur nuk ka nevojë të jepet përgjigja prej Gjykatës Supreme të Kosovës për lëndën në fjalë.

Pasi që të metat e dispozitivit kërkojnë prishjen e aktgjykimit, Gjykata Supreme përmbahet prej vendosjes nga kundërshtimet tjera të ngritura prej avokatëve mbrojtës kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Megjithatë, Gjykata Supreme me qëllim të shmangies së komplikimeve të mëtutjeshme gjatë rigjykimit e sheh nevojën e tërheqjes së vëmendjes të disa çështjeve tjera.

Pamjaftueshmëria e lartpërmendur në vërtetimin e fakteve gjithashtu pasqyrohet në pjesët tjera të aktgjykimit siç është përshkrimi jo i plotë i lëndimeve të viktimës⁵. Përshkrimi preciz i raporteve të autopsisë do të mund të zbulonte se D. A. ka vdekur prej të shtënave që kanë qëlluar kokën e tij kryesisht në pjesën e prapme. Viktima tjetër, T. A., vdiq prej të shtënave të cilat e qëlluan kokën e tij prej anës së prapme dhe prej anës së djathtë. Kjo e bën të diskutueshëm nëse i akuzuari ka pasur “rol të rëndësishëm në zënien në pusi” duke qëndruar në pjesën e përparme të veturës.

Gjykata e shkallës së parë e bazoi konkluzionin e saj lidhur me “rolin e dukshëm” të të akuzuarit në deklaratën e dëshmitarit L. A., edhe pse L. A. nuk e ka përmendur këtë detaj të veçantë gjatë shqyrtimit gjyqësor⁶. Ai e ka raportuar këtë detaj vetëm gjatë marrjes në pyetje prej gjyqtarit hetues me datën 14 prill 2004. Në të vërtetë gjykata e shkallës së parë i dha rëndësi të veçantë këtij detaji⁷ edhe pse dëshmitari L. A. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka qenë i konfrontuar (ballafaquar) me këtë detaj të deklaratës së tij të mëparshme. Dëshmitari L. A. ishte ballafaquar me deklaratën e tij të mëparshme të dhënë para gjyqtarit hetues⁸, megjithatë vetëm në lidhje me pyetjen nëse T. A. ka përmendur emrat dhe gjithashtu mbiemrat e sulmuesve. Ai nuk ishte ballafaquar me vërejtjen e pretenduar të T. A. “D. A. ishte përpara”. Kështu që ky detaj nuk është konfirmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe si pasojë nuk mund të përdoret kundër të akuzuarit.

⁴ Shih 4.9 Dënimi

⁵ Shih 4.2. Autopsitë

⁶ Shih procesverbalin e datës 5 maj 2009

⁷ Shih informatën plotësuese 5 të aktgjykimit të ankimit

⁸ Shih procesverbalin e datës 5 maj 2009, faqe 10 dhe 21



Veç kësaj, duke e përdorur këtë detaj kundër të akuzuarit do të mund të kërkohej vlerësim i plotë se pse dëshmitari L. A. e përmendi një detaj kaq të veçantë vetëm një herë para gjyqtarit hetues dhe më kurrë nuk e përsëriti, bile nuk e përsëriti edhe gjatë marrjes së tij në pyetje në shqyrtimin e mëhershëm gjyqësor kundër A. N. dhe R. B.⁹

Shqetësimet e mëtutjeshme lidhur me përcaktimin e fakteve ngrihen prej refuzimit të propozimeve për inspektimin e vendngjarjes së krimit. Në vend të kësaj, gjykata e shkallës së parë mbështeti procesverbalin e inspektimit të vendngjarjes së krimit i zhvilluar nga një trup tjetër gjykues në shqyrtimin mëhershëm kundër të pandehurve tjerë dhe nga skica e vendit të krimit i cili i është bashkangjitur aktgjykimit. Kjo nuk duket të reflektoj parimin e ekzaminimit të drejtë dhe të plotë të lëndës pasi që mbrojtja kryesisht sfidoi saktësinë e disa deklaratave të dëshmitarëve të bazuara mbi arsyen që distancat/rrethanat në vend ngjarjen e krimit nuk ka lejuar vrojtimit e raportuara prej dëshmitarëve. Veç kësaj, duket se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur një fotografi të saktë të vendngjarjes së krimit. Skica në të cilën gjykata e shkallës së parë është mbështetur nuk është të masë (peshoj) dhe si pasojë nuk jep fotografi të qartë të zonës. Dëshmitari L. A. , gjithashtu nxjerri në pah se skica nuk është e saktë dhe nuk pasqyron drejtimin e rrugëve me saktësinë e dëshiruar¹⁰. Fotografia e përpiktë e vend ngjarjes së krimit dhe të zonës rrethuese, megjithatë është e një rëndësie të madhe duke dhënë fakte kontradiktore të dëshmitarëve lidhur me distancat. Në vend të kësaj, del se në aktgjykimin e shkallës së parë shkronjat e caktuara prej trupit gjykues në pikat specifike në skicë¹¹ nuk përshtaten në tërësi me vet skicën. Shkronja "B", për shembull, do të duhet të shënonte shtëpinë e R. dhe P. B. , edhe pse në skicë një shtëpi tjetër shumë larg nga pika "B" është shënuar si "shtëpia e B. ". Aktgjykimi gjithashtu i referohet shkronjës "F" e cila do të duhej të shënoj shtëpinë e A. N. . Shkronja "F", megjithatë nuk mund të gjendet në skicë. Në anën tjetër, një grup i shtëpive është shënuar në skicë me shkronjën "L", edhe pse kjo shkronjë nuk paraqitet në listë në aktgjykim.

Shqetësimet e mëtutjeshme lidhur me përpikërinë e përcaktimit të situatës faktike shfaqet prej vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit L. A. .

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të rregullt caktoi rëndësi të lartë në këtë dëshmitar. Megjithatë, nuk paraqitet të jetë sa duhet i marr parasysh që ky dëshmitar dëshmoi pjesën më të rëndësishme të ngjarjeve, d.m.th. vetë të shtënat, vetëm nga thashethemet. Deklarata e dëshmitarit okular të këtyre ngjarjeve ekziston vetëm prej një prej viktimave, T. A. , e cila fillimisht i mbijetoi sulmit dhe ndërroi jetë disa orë më vonë. Kështu që, T. A. është dëshmitari i vetëm okular i të shtënave që ka qenë në gjendje që paksa të bisedoj me L. A. dhe të tjerët lidhur me ngjarjet.

Në këtë situatë qasja e gjykatës së shkallës së parë që të merret gjerësisht me deklaratat e dhëna nga L. A. dhe të vlerësoj "deklaraten" e të lënduarit rëndë T. A. vetëm në aspektin e aftësisë së tij fizike që të flas është i pamjaftueshëm, sepse e pranon

⁹ Shih procesverbalin e datës 1 mars 2005 në lëndën P. Nr. 1/05, Gjykata e Qarkut në Pejë

¹⁰ Shih procesverbalin e datës 5 maj 2009, faqe 21 versioni në gjuhën angleze

¹¹ Shih 3. Meritat e lëndës



përshkrimin e ngjarjes nga T. A. si të saktë dhe të vërtetë pa asnjë vlerësim të mëtutjeshëm. Megjithatë, dyshimet lidhur me saktësinë e raportit të tij ngrihen prej aktgjykimit të shkallës së parë sipas së cilës T. A. gjithashtu i përmenduri L. si një prej sulmuesve që gjithashtu sipas aktgjykimit të shkallës së parë i ka takuar sulmuesit pak më vonë në një vend tjetër dhe ishte e qartë që nuk ishte në vend ngjarjen e të shtënave.

Si konkluzion një vlerësim i kujdesshëm dhe i plotë i tërë fakteve në dispozicion duke përfshirë raportet e autopsisë, fotografitë, raportin e vendngjarjes së krimit etj. Duhet të bëhen gjatë rigjykimit me qëllim të vërtetimit sa më të saktë të mundshëm të vet ngjarjes së të shtënave. Si hap i dytë kontributi i të akuzuarit duhet të vlerësohet me përpikëri me qëllim të përcaktimit të fajit të tij personal.

Për aplikimin e dispozitave të ligjit penal, në rast se i akuzuari do të shpallet fajtor, Gjykata Supreme e Kosovës nxjerr në pah vijuesen.

Ligji i aplikueshëm është në përgjithësi ligji i cili ishte në fuqi në kohën kur ka ndodhur krimi. Megjithatë, pasi që Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) hyri në fuqi pas kryerjes së krimit, gjykata në pajtim me nenin 2 të KPPK-së aplikoi ligjin më të favorshëm. Vlerësimi se cili ligj është më i favorshëm nuk mund të bëhet *in abstracto* bazuar në akuzat e aktakuzës. Gjykata Supreme e Kosovës tanimë sqaroi në vendimet e mëparshme¹² që ekzistojnë disa rregulla specifike që i bashkëngjiten parimit të ligjit më të favorshëm. Megjithatë, kryesisht,

“duhet të theksohet që krahasimi i ‘ashpërsisë’ në mes të ligjit të ri dhe atij të vjetër nuk është bërë në lidhje me këto ligje (apo dispozitave specifike) të marra *in abstracto*, por gjithmonë në lidhje me përfundimin e aplikimit të këtyre ligjeve në rastin konkret. Si pasojë praktike është se vepra nën konsideratën gjyqësore duhet të vlerësohet me ligjin e vjetër dhe me ligjin e ri e pastaj të krahasohen rezultatet. Nëse rezultati për të akuzuarin është i njëjtë me ligjin e vjetër dhe me ligjin e ri (...), KPPK-ja kërkon që të aplikohet ligji i vjetër”¹³.

Për më tepër, gjykata e shkallës së parë solli dy (2) dënime të veçanta për të akuzuarin për dy (2) lëndë të vrasjes¹⁴. Duke e bërë këtë gjykata dështoi të marr parasysh nenin 30 paragrafi 3 të LPK-së që thotë:

¹² AP KZ 382/2003

¹³ Shih gjithashtu AP KZ 490/2003 e Gjykatës Supreme të Kosovës

¹⁴ Diskutimi i avokatëve mbrojtës se i akuzuari ishte shpallur fajtor vetëm për vrasjen e D. A. është bazuar në gabimin në përkthim të aktgjykimit prej origjinalit në gjuhën angleze në atë të gjuhës shqipe.



- (3) *Dënimi sipas paragrafit 2 të këtij neni do të vihet personit që ka kryer disa vrasje me paramendim ... duke e shpërfillur faktin se ai është duke u gjykuar për të gjitha vrasjet nga aplikimi rregullorëve të lidhura me bashkëveprimin apo faktin që ai ka qenë më herët i dënuar për vrasje tjetër.*

Qartë, në bazë të mendimit të gjykatës së shkallës së parë që i akuzuari është fajtor duke i privuar nga jeta dy (2) viktimë, neni 30, paragrafi 3 të LP-së do të mund të ishte i aplikueshëm në këtë rast dhe do të mund të kishte parandaluar detyrimin e dënimit të veçantë për secilin prej dy (2) vrasësit e viktimave.

2. Ankesa e parashtruar në emër të palëve të dëmtuara

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së parë është prishur dhe lënda është kthyer në rigjykim, ankesa e parashtruar në emër të palëve të dëmtuar për momentin nuk është objekt i çështjes në lëndë.

III. Paraburgimi

Paraburgimi i të akuzuarit duhet të vazhdohet për dy (2) muaj.

Gjykata Supreme vëren se i akuzuari ka qenë në paraburgim për pothuajse dy (2) vite. Megjithatë, ekzistojnë arsye për të mbajtur atë më tutje në paraburgim.

Sipas situatës së dukshme ekziston ende dyshimi i bazuar që i akuzuari ka kryer krimin i cili i vihet në barrë. Gjithashtu ende ekziston rreziku i ikjes. Shumë pak kohë pas ngjarjeve me 19 mars 2004 i akuzuari e lëshoi Kosovën, duke përdorur pasaportë false. Veç kësaj ekzistojnë baza për të besuar që ai do të ndikoj në dëshmitarë. Krimin që ai gjoja se e kryer shfaqet prej situatës së gjakmarrjes në mes të dy familjeve që jetojnë afër njëra tjetrës në një fshat të vogël. Shumica e dëshmitarëve gjithashtu jetojnë në këtë fshat dhe kështu janë posaçërisht të cënueshëm në kërcënime apo ndonjë mjet tjetër të ndikimit. Përfundimisht, vazhdimi i paraburgimit nuk mund të shihet si i tepërt për krimin e pretenduar dhe dënimi që i akuzuari duhet të ballafaqohet në rast se do të shpallet përsëri fajtor. I akuzuari akuzohet me vrasjen e dy personave dhe kështu ballafaqohet me dënimin prej së paku dhjetë (10) vite burgim në pajtim me nenin 30 paragrafi 2 dhe 3 të LPK-së.



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
AP – Kž. Nr. 368/2009

Kryetar i trupit gjykues

Norbert Koster

Anëtar i trupit gjykues


Gerrit-Marc Sprenger

Anëtar i trupit gjykues

Avdi Dinaj

Anëtare e trupit gjykues

Valdete Daka



Emine Mustafa